



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 tetor 2022
Nr. Ref.:RK 2057/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI64/22

Parashtrues

Vatani Shpk

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit Ac. nr. 2572/20, të 23 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga subjekti juridik Vatani Shpk, me seli në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson i autorizuari Avni Leci, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Ac. nr. 2572/20] të 23 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin [CPK. nr. 130/2018], e 5 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore në Gjiilan.
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 24 janar 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar], në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 maj 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 23 maj 2022, Gjykata, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, gjithashtu një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
8. Më 23 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 23 maj 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Gjiilan informata përkitazi me datën e pranimi të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 31 maj 2022, Gjykata Themelore në Gjiilan informon Gjykatën se më 15 shkurt 2022 komplet lënda i është dorëzuar përmbaruesit privat I. Sh., dhe se për këtë arsye nuk ishte e mundur bashkëngjitja e fletëkthesës si dëshmi e pranimi të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
11. Më 14 korrik 2022, Gjykata kërkoi nga përmbaruesi privat I. Sh. që të dorëzonte në fletëkthesën si dëshmi e pranimi të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nga parashtruesi i kërkesës.

12. Më 26 korrik 2022, përmbartuesi privat I. Sh. dorëzoi në Gjykatë një kopje të fletëkthesës, nga e cila rezulton se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 24 janar 2022.
13. Më 29 shtator 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Kërkesa bën fjalë për një kontest civil-pronësor (pasuri), mes parashtruesit të kërkesës dhe ortakut të tij Niga Profil Shpk. Kjo ortakëri faktike dhe juridike ishte themeluar më 8 gusht 1995, nga e cila janë themeluar më pas katër subjekte juridike Bitex Shpk, Niga Profil Shpk, Gritankos Shpk dhe Europlast Shpk, dhe nga pasuria e përbashkët ortakët kanë krijuar prona të paluajtshme në Prishtinë-Çagllavicë, Harilaç dhe në Gjilan. Kontrata e ortakërisë ndërmjet ortakëve u shua në fund të vitit 2016.
15. Më 27 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi (IEK nr. 622/2017) për shuarjen e ortakërisë në Gjykatën Themelore në Gjilan, me subjektet juridike Bitex Shpk, Niga Profil Shpk, Gritankos Shpk dhe Europlast Shpk me pronar Sh.N. Vlera e propozuar e kontestit 828.812,00 euro.
16. Më 26 shtator 2018, përmbartuesi privat Isa Shala, sipas propozimit të subjektit juridik Niga Profik Shpk (kreditore) lëshon Urdhrin përmbartimor P. nr. 834/18 për pagesën e shumës monetare prej 71.107,50 euro, përfshirë kamatën ligjore në lartësinë prej 8% (përqind) dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nga ana e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 1 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës ndaj Urdhrit përmbartimor P. nr. 834/18 ka ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 3 tetor 2018, përgjigje në prapësim ka ushtruar dhe pala kreditore me propozimin që të lihet në fuqi Urdhri përmbartimor P. nr. 834/18 dhe të refuzohet prapësimi si i pabazuar, duke theksuar se kreditore dhe debitori kanë pasur raporte afariste në mes vete dhe si rezultat është krijuar borxhi nga ana e debitorit.
19. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata Themelore në Gjilan me Aktvendimin CPK. nr. 130/2018: i.) refuzoi si të pabazuar prapësimin e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës (debitori), ii. la në fuqi Urdhrin përmbartimor P. nr. 834/18, dhe iii. obligoi parashtruesin e kërkesës (debitori) që në rast të ushtrimit e ankesës të paguaj shumën prej 2000 euro, në emër të garancisë në pajtim me nenin 78 të LPP-së, me arsyetimin vijues: *"Pas analizimit të shkresave të lëndës, gjykata konstatoi se prapësimi i debitorit i dt. 01.10.2018, është i pabazuar, për arsye se i njëjti nuk ka vërtetuar asnjë nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, lidhur me bazueshmërinë e prapësimit, sepse faturat të cilat janë lëshuar nga kreditore dhe pranuar nga debitori, mbi të cilat bazohet propozimi për përmbartim dhe pastaj nga ana e Përmbartuesit Privat lejohet Urdhri përmbartimor, janë dokumente të besueshme-titull përmbartimor konform nenit 29 paragrafi 1, nënparagrafi 1..1 të LPP-së"*.
20. Më 18 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës ndaj aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjilan, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit të aprovoi ankesën e parashtruesit

të kërkesës (debitorit) si të bazuar dhe të prishë aktvendimin e atakuar, ndërsa lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

21. Në një datë të pasaktësuar, subjekti juridik Niga Profik Shpk (kreditore) në Gjykatën Themelore në Gjilan dorëzoi përgjigje në ankesë, me propozimin që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar nga Gjykata e Apelit dhe Aktvendimi i 5 dhjetorit 2018 i Gjykatës Themelore në Gjilan të konfirmohet.
22. Më 23 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. nr. 2572/20, nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e 5 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore në Gjilan, duke arsyetuar: *“Duke marrë parasysh pretendimet tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, e as të LPP-së. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e debitorit”.*
23. Më 4 shkurt 2022, parashtruesi i kërkesës i propozoi Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që të ngrente kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2572/20] të 23 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit [CPK. nr. 130/2018] të 5 dhjetorit 2018 të Gjykatës Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve të dispozitave përmbarimore dhe kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 4 prill 2022, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me njoftimin KMLC. nr. 12/2022, refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se në këtë çështje juridike nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247 paragrafi 1 pika a) dhe pikës b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara, me nenet 24, 31, 54 dhe 102 të Kushtetutës si dhe me nenin 6 dhe 13 të KEDNj-së.
i. Pretendimit për shkelje të parimit të “barazisë para ligjit” dhe të “barazisë së armëve”
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkelja e nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës, ka ndodhur për shkak se gjykatat e rregullta nuk morën për bazë pretendimet e tij, me të cilat është njoftuar gjykata se pala kundërshtarë (kreditore) e ka inicuar procedurën përmbarimore me keqbesim dhe duke e vënë në lajthitje gjykatën me fatura fiktive dhe juridikisht të paqëndrueshme. Kjo pasi që pronarët e të dy subjekteve juridike, në momentin e lëshimit të faturave, kanë qenë ortakë faktik/formal dhe se me të gjitha subjektet juridike të themeluara që i kanë pasur në pronësi kanë udhëhequr së bashku.
27. Parashtruesi gjithashtu thekson se për të vërtetuar validitetin e prapësimit dhe thëniet në prapësim është e domosdoshme mbajtja e një seance dëgjimore, megjithatë gjykata duke shkelur parimin e barazisë së palëve në procedurë nuk e mori parasysh kërkesën e tij dhe me këtë rast këtij subjekti juridik nuk i është ofruar mbrojtje e barabartë gjyqësore në raport me palën kundërshtarë. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se nga mosvërtetimi i fakteve thelbësore nga gjykatat e rregullta i njëjti është dëmtuar materialisht në vlerën prej 71.107,50 euro, pa llogaritur kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e shkallës së dytë, nuk i dhanë barazi para ligjit dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse shkelen dy parimet themelore të procedurës përmbartimore dhe nga shkelja e këtyre dy parimeve erdhi deri te shkelja e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”*. E gjitha, sipas tij si rezultat i shkeljes së nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore, ku sipas parashtruesit të kërkesës, paragrafi 2 i këtij neni në mënyrë decisive parasheh se *“... organi përmbartuarës cakton seancën dëgjimore, atëherë kur një gjë e tillë është e paraparë, me këtë ligj ose kur mendon së një e tillë është e dobishme”*. Duke shtuar se në rastin konkret mbajtja e seancës dëgjimore ishte e domosdoshme, për t'u dhënë mundësi palëve ndërgjyqëse për t'u deklaruar, se për çfarë aspekti janë lëshuar faturat nga ana e kreditorit, se a ekziston dëshmi për pranim-dorëzimin e mallit - furnizimin e mallit të bërë nga kreditori ndaj debitorit - element thelbësor për t'u quajtur si e rregullt një faturë, se a ekziston ndonjë marrëdhënie juridike - marrëveshje në mes palëve lidhur me furnizimin me mall nga ana e kreditorit tek debitori dhe vetëm pas sqarimit të këtyre rrethanave të kontestuara nga pala debitore me mbajtjen e seancës dëgjimore, Gjykata është dashur që të marr vendim për këtë çështje juridiko - përmbartimore.

ii. Pretendimet për “moskonsistencë të praktikës gjyqësore”

29. Përveç pretendimeve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës ngre pretendime edhe për praktikën gjyqësore jokonsistente, duke theksuar se gjykatat e rregullta në këtë procedurë përmbartimore, kanë vendosur në kundërshtim me praktikën gjyqësore të tyre, duke përmendur rastin PPP. nr. 308/2021 të 21 janarit 2022 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, e cila para marrjes së vendimit lidhur me prapësimin e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës ka mbajtur paraprakisht seancë dëgjimore për të vërtetuar validitetin e prapësimit. Tutje, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, me Vendimin PPP. nr. 59/2018, të 12 marsit 2019, ka udhëzuar kreditorin që përkitazi me verifikimin e faturave (dokumente të besueshme), si në rastin konkret, të iniciojë paraprakisht procedurë kontestimore, konform nenit 260 të LPP-së.
30. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata e Apelit paraprakisht është njoftuar me parashtruesin e 8 shkurtit 2021, se ekzistojnë praktika gjyqësore të ngjashme, përkitazi me rastin konkret, rreth vërtetësisë së faturave, ku gjykatat vendosën që të njëjtat verifikohen në procedurë kontestimore. Por, sipas tij edhe pse Gjykata e Apelit ka qenë në dijeni për praktikën e ngjashme gjyqësore, e njëjta ka marrë aktvendim në kundërshtim me ligjin, pa vërtetuar autenticitetin e faturave dhe mënyrën e lëshimit të tyre, e posaçërisht pa vërtetuar faktet, nëse ishte dërguar malli tek pala debitore, duke vendosur që shuma e detyrimit sipas faturave të përmbartohet me të gjitha këto të meta.
31. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Aktvendimi ... Ac. nr. 2571/2020 i datës 23.12.2021, i marrë nga Gjykata e Apelit, përpos që është marrë në kundërshtim me të drejtat të cilat i ka të garantuara ... me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ-së, të ndërthurura me dispozitat ligjore të lartcekura, i njëjti është marrë edhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të ngjashme të cilat i gjykon, po e njëjta gjykatë dhe me natyrë të njëjtë, ku pronari i palës kundërshtare ka qenë i njëjtë dhe me fatura të ngjashme ka tentuar që të ekzekutoj një shumë tjetër të kryegjësë prej 246.015,25 Euro. Por, e njëjta gjykatë pikërisht për shkak se këto fatura nuk kanë qenë në mënyrë të rregullta, duke pas për bazë natyrën e raporteve të pronarëve të palëve ndërgjyqëse në kohën e lëshimit të faturave dhe në mungesë të marrëveshjes juridike për furnizim me mall, e njëjta gjykatë nuk ka vendosur për lejimin e ekzekutimit të këtyre faturave dhe ka kthyer lëndën në rivendosje. Praktika e ngjashme gjyqësore e marrë nga Gjykata e Apelit të Kosovës, por e vendosur ndryshe, përkatësisht konform*

të drejtave të përcaktuara me ligj të cilat i theksuam më lart: - Rasti i ngjashëm identik me rastin në fjalë, ku ndryshon vetëm emri i kreditorit por jo edhe pronari Sh.N: aktvendimi i marrë nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me numër Ac. nr. 5075/20 i datës 28.04.2021, me këtë vendim e njëjta gjykatë ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit "Vatani shpk" me seli në Gjilan, II prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK. nr. 129/2018 i datës 18.09.2020 dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje".

iii.Pretendimet tjera të shkeljes së të drejtave kushtetuese

32. Përpos pretendimeve të mësipërme, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i 23 dhjetorit 2021, i ndërlidhur me Aktvendimin e 5 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore në Gjilan është marrë pa u vërtetuar faktet, përkatësisht pa u mënjanuar të gjitha kundërshtimet, të cilat i ka paraqitur i njëjti pranë kësaj gjykate, duke shtuar se shumica e borxhit të kërkuar nga kreditori nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 29, paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, në ndërlidhje me nenet 44, 45 paragrafi 1 pika 1.7 të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe nenin 104, paragrafin 1 të Ligjit të marrëdhënieve detyrimore.
33. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykata nuk vërtetoi faktin nëse ishin plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 45, paragrafi 1, pika 1.7 të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, për të caktuar përmbajtjen e faturës në mënyrë që e njëjta të quhet si e rregullt në kuptim të këtij ligji. Në këtë këndvështrim, parashtruesi i kërkesës thekson: *"Duke mos e arsyetuar vendimin se çka quajmë faturë në procedurë përmbartimore dhe se duke mos iu referuar ligjit special, që rregullon mënyrën e lëshimit të faturave kur kemi të bëjmë me dy subjekte juridike si në rastin konkret. Që patjetër duhet të zbatohet ligji special në rast se, si në rastin konkret ligji i procedurës përmbartimore vetëm ka cilësuar si dokument të besueshëm-faturat, por përmbajtjen e faturës në mes dy subjekteve të tatueshme e përcakton ky ligji special, ku faturat të cilat janë pranuar si të rregullta nga dy gjykatat e instancave të lartcekura, janë lëshuar pikërisht në kundërshtim me nenin 44 dhe 45 të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar".*
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me nenin 102 të Ligjit të marrëdhënieve të detyrimeve dhe me nenin 194 të Ligjit të procedurës kontestimore. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta nuk kanë vepruar në pajtim me nenin 102 të Kushtetutës, sepse nuk i kanë siguruar të njëjtit qasje të barabartë në gjykatë, për shkak të mohimit të së drejtës për të vërtetuar faktet e lëshimit të faturave nga pala kundërshtare.
35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: të deklarojë kërkesën e pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24, nenit 31, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, nenit 54, në lidhje me nenin 102 (2 dhe 3) të Kushtetutës, dhe të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin Ac. nr. 2571/2020 të Gjykatës së Apelit dhe të kthejë të njëjtin në rivendosje, në pajtim me konstatimet e Gjykatës.

Dispozitat relevante

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 102

[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.

2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 13
(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Neni 73

Vendosja sipas prapësimit

1. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

38. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund të ngrenë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”.

39. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 568/2020, të 7 majit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtguesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
40. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtguesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtguesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethanave të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vetë nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtgues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
42. Gjykata rikujton se parashtguesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet

24, 31, 54 dhe 102 të Kushtetutës, për arsye se gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore nuk u morën parasysh faktet thelbësore në lidhje me vërtetësinë e faturave dhe nuk është mbajtur seancë dëgjimore siç e parashihte ligji, dhe se në rastin konkret gjykata vendosi në kundërshtim me praktikën gjyqësore.

43. Nga ky përkufizim, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në esencë ka të bëjë me i) mënyrën e vërtetimit e fakteve dhe zbatimin e ligjit material, ii) shkeljen e parimit të barazisë së armëve, dhe me iii) moskonsistencën e praktikës gjyqësore të gjykatave. Në këtë kontekst, Gjykata do t'i shqyrtojë këto pretendime në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

I. Përkitazi me “vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit”

44. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i 23 dhjetorit 2021, i ndërlidhur me Aktvendimin e 5 dhjetorit 2020 të Gjykatës Themelore në Gjilan është marrë pa u vërtetuar faktet, përkatësisht pa u mënjanuar të gjitha kundërshtimet, të cilat i ka paraqitur i njëjti pranë gjykatave, duke shtuar se shumica e kërkuar nga kreditori nuk i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 29, paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, në ndërlidhje me nenet 44, 45, paragrafi 1 pika 1.7 të Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe nenin 104, paragrafin 1 të Ligjit të marrëdhënieve detyrimore. Si rezultat, i njëjti pretendon se nga mosvërtetimi i fakteve thelbësore nga gjykatat e rregullta është dëmtuar materialisht në vlerën prej 71.107,50 euro, pa llogaritur kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.
45. Referuar pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në këtë pjesë e ka ndërtuar kërkesën e tij në baza ligjshmërie dhe jo në baza kushtetutshmërie, duke pretenduar se gjykatat e rregullta nuk kanë vërtetuar faktet e çështjes në mënyrën e paraprë me ligj dhe nuk kanë zbatuar drejt ligjin material. (shih, në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, rasti [KI76/21](#), me parashtrues Qemajl Babuni, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 33).
46. Gjykata rikujton se bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila ndërlidhet me doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht e ka qartësuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNj (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtrues Belgjyzar Latifi, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues Shogëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), me parashtruese Lumturije Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17 dhe KI05/18](#), me parashtrues, Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues Qemajl Babuni, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
47. Gjykata vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e

“shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48; dhe [KI154/17 dhe KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).

48. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih, rastin e GjEDNj-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GjEDNj-së për nenin 6 të KEDNj-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty, dhe së fundmi rasti [KI76/21](#), parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 36).
49. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se efektet e interpretimit dhe të zbatimit të së drejtës materiale janë jokompatible me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj. Për më tepër, nga arsyetimi i aktvendimit të kontestuar vërehet qartë se në rrethanat e rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me “aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar” dhe as me “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme”.
50. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, lidhur me vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit, bien në kategorinë e parë (i) të pretendimeve të “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe nuk janë argumentuar në nivel kushtetutshmërie, andaj, si të tilla, të njëjtat duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të parimit të “barazisë së armëve”

51. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se parimi i barazisë së armëve është një tipar i qenësishëm i një gjykimi të drejtë. Në parim, ai kërkon që secilës palë në procedurë t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij në kushte të cilat nuk e vendosin atë në disavantazhë kundrejt kundërshtarit të tij (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, [Öcalan kundër Turqisë](#), nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafi 140; [Foucher kundër Francës](#), nr. 22209/93, Aktgjykim i 18 marsit 1997, paragrafi 34; [Bulut kundër Austrisë](#), nr. 17358/90, Aktgjykimi i 22 shkurtit 1996; dhe [Faig Mammadov kundër Azerbajxhanit](#), nr. 60802/09, Aktgjykimi i 26 janarit 2017, paragrafi 19). Ky parim është gjithashtu i lidhur

ngushtë me të drejtën për një seancë në të cilën mund të kundërshtohen provat e që do të thotë, në parim, mundësinë e palëve që të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi të gjitha provat e paraqitura e që mund të ndikojnë në vendimin e gjykatës (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së *Brandstetter kundër Austrisë*, nr. 13468/87, Aktgjykim i 28 gushtit 1991, paragrafi 67).

52. Gjykata rikujton se pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e këtij parimi qëndron në faktin se atij si palë debitore nuk i është mundësuar mbrojtje e barabartë për t'i ballafaquar argumentet dhe kundërgargumentet kundër palës kreditore, duke konsideruar se mbajtja e saj sipas nenit 22 të LPP-së ishte e domosdoshme për të vërtetuar të kundërtën e pohimeve të palës kundërshtare (kreditoret).
53. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [Ac. nr. 2572/20] të 23 dhjetorit 2021, në lidhje me këtë pretendim, arsyetoi: *"Gjykata e Apelit vlerëson se, pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore nga neni 73 të LPP-së, duke mos caktuar seancë dëgjimore me qëllim të vërtetimit të thënieve në prapësim, për Gjykatën e Apelit janë pretendime tërësisht të pathemelta për faktin se me dispozitën e nenit 73, paragrafi 1 të LPP-së, ku përcaktohet se "gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seance gjyqësore". Përgjithësisht, gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse, Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohen nga Gjykata". Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë sa i përket pikës II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që është në diskrecionin e gjykatës së shkallës së parë që të caktojë seancë dëgjimore vetëm në rastet kur një gjë e tillë është e dobishme për vërtetimin e ndonjë fakti, gjë që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur duke mos caktuar seancë dëgjimore pasi që përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të cilat paraqesin dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, janë në origjinal, ashtu që siç përcaktohet me nenin 40 par.1 dhe 1.3 të LPP-së dhe të njëjtat janë të pranuar dhe nënshkruara nga debitori dhe po ashtu të njëjtat paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të të njëjtit ligj".*
54. Sa më sipër, Gjykata vëren se caktimi i seancës dëgjimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sipas ligjit të aplikueshëm në fuqi, përbën një të drejtë diskrecionale të asaj gjykate që të vendos për mbajtjen ose mosmbajtjen e një seance dëgjimore, dhe atë në rastet kur gjykata në gjykimin e saj e konsideron të dobishme dhe të nevojshme qartësimin e rrethanave faktike të rastit. Në rastin konkret, duke e adresuar këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit ka konsideruar se faturat e dokumentuara para tyre, ashtu siç me të drejtë ka konsideruar dhe shkalla e parë, paraqesin dokument të besueshëm në kuptim të ligjit (titulli përmbartimor), ashtu siç përcakton neni 40, paragrafi 1 dhe 1.3 i LPP-së dhe nenin 21 i të njëjtit ligj.
55. Duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve, i cili në kuptim të nenit 6.1 të KEDNj-së është i ndërlidhur ngushtë me të drejtën për seancë dëgjimore dhe duke analizuar konstatimet e Gjykatës së Apelit, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështes pretendimin e tij për shkelje të kësaj të drejte, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, nga arsyet e elaboruara, si më sipër.

56. Andaj, nga këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me barazinë e armëve i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse kërkesa në këtë pjesë është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

III. Përkitazi me “praktikën gjyqësore jokonsistente”

a. Parimet e përgjithshme

57. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNj-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.
58. Lidhur me parimin e parë, GjEDNj është përqendruar në parimin e sigurisë juridike e që në këtë kontekst është e mishëruar në të gjitha nenet e KEDNj-së dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit (shih rastin e GjEDNj-së, [*Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*](#), nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56). Ky parim garanton një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon në besimin e publikut në gjykata. Vazhdimësia e divergjencës në praktikë gjyqësore mund të krijojë situata të pasigurisë juridike duke rezultuar në ulje të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, ndërsa ky besim është qartazi njëri nga komponentët thelbësorë të shtetit që bazohet në sundim të ligjit (shih, në këtë kontekst rastin e GjEDNj-së, [*Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë*](#), nr. 30123/10, Aktgjykim i 30 korrikut 2015, paragrafi 42; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [*KI175/20*](#), parashtruese, *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 55).
59. Lidhur me parimin e dytë, GjEDNj ka konstatuar se kërkesat e sigurisë juridike dhe të mbrojtjes së besimit legjitim të publikut, megjithatë nuk garantojnë një të drejtë të fituar në konsistencë të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e drejtë të drejtësisë pasi që mosruajtja e një qasje dinamike dhe evolutive, do të rrezikonte të pengojë reformën ose përmirësimin e vazhdueshëm (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, [*Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*](#), cituar më lart, paragrafin 58; dhe [*Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [*KI175/20*](#), *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafët 56 dhe rastet e cituara aty).
60. Lidhur me parimin e tretë, GjEDNj ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykate. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNj-në (shih rastet e GjEDNj-së, [*Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*](#), cituar më lart, paragrafi 51; [*Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#) dhe 63 (gjashtëdhjetë e tri) kërkesa tjera, nr.34796/09 Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; [*Santo Pinto kundër Portugalisë*](#), nr. 39005/04, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe [*Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*](#), cituar më lartë, paragrafi 122; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [*KI175/20*](#), *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafët 57).

61. E fundit dhe në lidhje me parimin e katërt, GjEDNj ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (shih, për shembull, rastet e GjEDNj-së [Adamsons kundër Letonisë](#), nr. 3669/03, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, GjEDNj-ja ka theksuar se trajtimi i dy kontesteve në mënyrë të ndryshme nuk mund të konsiderohet se krijon praktikë gjyqësore divergjente kur kjo arsyetohet nga një ndryshim në gjendjet faktike në fjalë (shih, rastet e GjEDNj-së, [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 116).
62. Gjithashtu, Gjykata vëren se qasja e GjEDNj-së në analizimin e divergjencave në praktikën gjyqësore, ndryshon në varësi të faktit nëse: (i) divergjencat ekzistojnë brenda të njëjtës degë të gjykatave; ose (ii) ndërmjet dy degëve të ndryshme të gjykatave të cilat janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Situata e dytë ka të bëjë me sistemet gjyqësore që përbëhen nga më shumë se një degë e sistemit gjyqësor, secila me gjykatën përkatëse e të pavarur supreme e që nuk i nënshtrohet ndonjë hierarkie të përbashkët gjyqësore. Rasti kryesor i GjEDNj-së lidhur me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën e praktikës gjyqësore, [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), bie brenda kësaj kategorie. Sidoqoftë, parimet themelore të vendosura përmes këtij rasti, përdoren gjithashtu në vlerësimin e divergjencave që kanë të bëjnë me praktikën gjyqësore edhe në rastet që i përkasin kategorisë së parë, përkatësisht, atyre me një sistem unik gjyqësor, që do të ishte rasti në kontekst të sistemit juridik të Republikës së Kosovës.
63. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GjEDNj-ja përdor tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, si në vijim: (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GjEDNj-së, [Beian kundër Rumanisë](#) (nr.1), nr.30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafët 116 - 135; [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 60).
64. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rithekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

b. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

65. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon së në rastin e tij gjykatat e rregullta kanë vendosur në kundërshtim edhe me praktikën gjyqësore, duke i

bashkëngjitur kërkesës si dëshmi: (i) Vendimin [PPP. nr. 59/18] e 12 marsit 2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega Lipjan, me të cilin ishte udhëzuar kreditori (PRO-ING, Prishtinë), që të iniciojë procedurë kontestimore, ndaj debitorit Komuna e Lipjanit, për realizimin e kredisë kontestuese, me ç'rast vendimi ishte shtyrë, deri në përfundimin e procedurës kontestimore; (ii) Vendimin [PPP.nr.308/21] e 21 janarit 2022 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, me të cilin ishte refuzuar prapësimi i debitorit (MEKA shpk) dhe ishte lënë në fuqi urdhri përmbarimor P. nr. 445/21, i 7 shatorit 2021; dhe (iii) Aktvendimin [Ac. nr. 5075/2020] e 28 prillit 2021 të Gjykatës së Apelit, me të cilin ishte aprovuar ankesa e debitorit dhe ishte kthyer çështja në rivendosje për t'u evituar paqartësitë që ndërlihdeshin me rregullsinë dhe autenticitetin e faturave të debitorit si dokumente përmbarimore.

66. Parashtruesi i kërkesës duke iu referuar Aktvendimit [Ac. nr. 5075/2020] të 28 prillit 2021 të Gjykatës së Apelit, thekson se *"Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit...është marrë edhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të ngjashme të cilat i gjykon, po e njëjta gjykatë dhe me natyrë të njëjtë, ku pronari i palës kundërshtare ka qenë i njëjtë dhe me fatura të ngjashme ka tentuar që të ekzekutoj një shumë tjetër të kryegjësë prej 246.015,25 euro"*.
67. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit, vetëm në raport me shkeljet e pretenduara nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, jokonsistenca në praktikën gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i *"dallimeve të thella dhe të afatgjata"* në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të jenë tërësisht identike me raste të cilave iu referohet parashtruesi i kërkesës.
68. Në lidhje me këtë, Gjykata nga përmbajtja e vendimeve të bashkëngjitura, vëren se rrethanat faktike të rastit konkret, nuk janë identike me ato të cilave iu është referuar parashtruesi i kërkesës, sepse në rastin e parë (i) gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë vendimmarrjen, duke konsideruar si kontestuese shumën e kredisë (borxhit), ndërsa në rastin e dytë (ii) gjykata e shkallës së parë, në fakt ka refuzuar prapësimin e ushtruar nga pala debitore dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor [P. nr. 445/21], të 7 shatorit 2021, nëpërmjet të cilit ishte kërkuar realizimi i borxhit.
69. Gjersa në rastin e tretë (iii) gjykata e shkallës së dytë, ku vërehet se palë debitore ka qenë parashtruesi i kërkesës (Vatani Shpk) dhe palë kreditore po i njëjti sikurse është në rastin konkret, kishte aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte kthyer çështjen në rivendosje në shkallën e parë për shkak të paqartësive që kishin të bënin me rregullsinë e faturave dhe autenticitetin e tyre. Përderisa, në rastin konkret, as gjykata e shkallës së parë dhe as gjykata e shkallës së dytë nuk e konsideruan kontestuese validitetin e faturave, si dokumente të besueshme (titullin përmbarimor) dhe ky fakt vërehet qartë nga arsyetimi i Gjykatës së Apelit, ku kjo e fundit thekson: *"Në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm, siç janë faturat e përmendura në propozimin për përmbarim dhe të njëjtat janë të përshtatshme për përmbarim ngase në to është cekur kreditori dhe debitori, objekti lloji dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, kështu që dokumentet të besueshme janë të plota, janë valide, të ekzekutueshme, kërkesat janë bërë të arritshme, nuk ka prova të reja se kërkesa në bazë të dokumenteve të besueshëm janë përmbushur, për më tepër që faturat janë në kopje të vërtetuara nga noteri, ashtu siç përcaktohet me nenin 40, par, 1 dhe 1,3 të LPP-së, andaj nga kjo rezulton se dokumentet e besueshme janë të përshtatshme për përmbarim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar"*.

70. Nga referimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës megjithatë nuk ka arritur të përmbushë kriterin, sa i përket “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” të praktikës gjyqësore, sepse nuk bëhet fjalë për rrethana faktike dhe juridike tërësisht identike siç kërkon ky kriter. Për më tepër edhe po të ekzistonin rrethana faktike dhe juridike, tërësisht identike mes rasteve në krahasim, Gjykata rikujton se nuk mund të ndërtohet një pretendim për jokonsistencë të praktikës gjyqësore, vetëm mbi bazën e krahasimit të një apo dy vendimeve dhe të konstatohet se ka pasur megjithatë “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, si instancë e fundit në procedurë përmbartimore.
71. Në lidhje me këtë, Gjykata në rastet e saj KI29/17, KI42/17, KI35/18 dhe KI107/19 dhe KI133/19, kishte vlerësuar, se nuk mund të konstatohen “*dallime të thella dhe afatgjata*”, në krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në këtë rast, në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit i referohen vetëm një vendimi, i cili përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi, i nxjerrë në rastin e parashtruesve, Gjykata nuk kishte konstatuar se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike (shih rastet e Gjykatës: [KI29/17](#), i cituar më lart, paragrafi 53; [KI42/17](#), i cituar më lart, paragrafi 44; [KI35/18](#), i cituar më lart, paragrafët 104 dhe 114; dhe [KI107/19](#), i cituar më lart, paragrafi 75; dhe së fundmi rasti [KI133/19](#), i cituar më lartë, paragrafin 58).
72. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vënë theks në faktin se divergjenca në praktikën gjyqësore jodetyrimisht është në kundërshtim me KEDNj-në, sepse qasja dinamike dhe evolutive e gjykatave në interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe për më tepër, zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë.
73. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës ka dështuar t’i ofrojë Gjykatës dëshmi në lidhje me “*dallimet e thella dhe afatgjata*” për të konstatuar se Gjykata Supreme në rastin e tij ka vendosur në kundërshtim me praktikën e konsoliduar gjyqësore, ndër vite. Për më tepër, nëse Gjykata do të lëshojë në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të Gjykatës Supreme, duke bërë krahasime dhe analizë, se cili prej vendimeve të Gjykatës Supreme është më i drejti dhe i bazuar në ligj, do të ndërhynte në juridiksionin dhe pavarësinë e gjyqësorit të rregullt.
74. Andaj, nga kjo arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me jokonsistencën në vendimmarrje i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

IV. Përkitazi me pretendimet tjera

75. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pretendon dhe në shkelje të nenit 24, 54 dhe 102 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës shkeljen e këtyre neneve e ka ndërlidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, përkatësisht me barazinë e armëve dhe moskonsistencën e praktikës gjyqësore, për të cilat pretendime Gjykata si më lart konstatoi se kërkesa në këto pjesë është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të neneve tjera të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja

e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KIo4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).

76. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24, 54 dhe 102 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara.

Përfundim

77. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës, lidhur me vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit, bien në kategorinë e parë (i) të pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe nuk janë argumentuar në nivel kushtetutshmërie, andaj, si të tilla, të njëjtat duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me barazinë e armëve dhe jokonsistencën në vendimmarrje i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse në këtë pjesë kërkesa, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar; (III) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24, 54 dhe 102 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla në baza kushtetuese, të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara.
78. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 29 shtator 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- I. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- II. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani